



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1610/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Ex Project” shpk, me numër unik identifikues 81065942, me seli ne Ferizaj rr. “Mulla Idriz Gjilani”, nr.5, ndaj debitorit “VB Invest” Shpk me numër unik identifikues 811310200, rr.”Hajrulla Abdullahu” Bregu i Diellit” pn, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës–Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.769/22 dt.20.09.2023, me datën 20.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit “Ex Project” shpk, me numër unik identifikues 81065942, me seli ne Ferizaj rr. “Mulla Idriz Gjilani”, nr.5, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.769/22 dt.20.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.769/22 dt.20.09.2023, ka aprovuar prapësimin e debitorit “VB Invest” shpk me numër unik identifikues 811310200, rr.”Hajrulla Abdullahu” Bregu i Diellit” pn dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.508/21 dt.01.09.2021 ti lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H.Aliu, për territorin e Gjykatës Themelore ne Ferizaj dhe ka përfunduar procedurën ne këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbartimore, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ne tërësi këtë ankesë, aktvendimin e atakuar ta shfuqizoj dhe urdhrin përmbartimor ta lë ne fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Ex Project” shpk, me numër unik identifikues 81065942, me seli ne Ferizaj rr. “Mulla Idriz Gjilani”, nr.5, me datë 01.09.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit “VB Invest” shpk me numër unik identifikues 811310200, rr.”Hajrulla Abdullahu” Bregu i Diellit” pn, në bazë të dokumentit te besueshëm –Faturave nr. 11/21 dt.08.03.2021, 16/21 dt.11.03.2021, 143/20 dt.29.10.2020, 151/20 dt.24.10.2020, 164/20 dt.02.11.2020, 165/20 dt.02.11.2020, 166/20 dt.04.11.2020, 187/20 dt.20.11.2020, 188/20 dt.23.11.2020, 189/20 dt.23.11.2020, 198/20 dt.27.11.2020. Përmbaruesi privat Besnik H.Aliu nga Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarimor Pnr.508/2021 dt.01.09.2021, ka urdhëruar debitorin qe kreditorit t’ia paguaj borxhin sipas faturave ne shumën prej 62,911.00 euro, me kamatë prej 8% nga dita e arritshmërisë se kërkesës për pagesë e deri ne pagesën definitive si edhe shpenzimet e procedurës.

Ndaj urdhrit përmbarimor, me datën 21.09.2021, prapësim ka ushtruar debitori, me arsyetimin se e konteston urdhrin përmbarimor sepse kreditori ka lëshuar fatura te cilat janë paguar nga ana e debitorit, kreditori me datën 14.10.2020 ka dërguar ne grupin e komunikimit me debitorin ne rrjetin social Viber faturën nr.138/20 dt.19.10.2020 ndërsa debitori ka bere pagesën e faturës nr.138/20 dhe dëshminë e pagesës te paraqitur ne grupin e komunikimit ne Viber. Debitori dhe kreditori janë marrë vesh qe debitori ti jap kreditorit një veturë ne vlerë prej 80,000.00 euro ndërsa debitori te furnizoj kreditorin me eksploziv ne vlerën e veturës si kompensim. Debitori prapësimin e mbështetë ne nenin 67 par.1 te LPP dhe pretendon se faturat ne bazë te cilave është lejuar përmbarimi nuk paraqesin dokument te besueshëm te përcaktuar me nenin 29 par.1 nenpar.1.3 te LPP, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin përmbarimor ta anuloj.

Përgjigje me debitorin kanë pasur bashkëpunim dhe ky bashkëpunim ka rrjedh nga vitit 2019, obligimi aktual i debitorit ndaj kreditorit është shumë me i lartë se sa është paraqitur ne propozim, marrëveshja me debitorin te cilën e kanë pasur ka qenë për një çështje tjetër, debitori nuk ka bere asnjë lloj pagese nga muaji Mars 23020 deri ne tetor 2020.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas shqyrtimit te prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.769/22 dt.20.09.2023, me te cilin ka aprovuar prapësimin e debitorit, urdhrin përmbarimor e ka anuluar dhe çështjen përmbarimore e ka përfunduar duke vendosur decidivisht si ne dispozitiv te këtij aktvendimi. Gjykata arsyeton se pas shqimit dhe analizimit te shkresave ne lënde dhe bazuar ne parashtrësën e dorëzuar nga vet kreditori me datën 14.09.2023 pranë kësaj gjykate, njofton se me debitorin kanë arritur marrëveshje për pagesën e borxhit sipas urdhri përmbarimor P.nr.508/2021 dt.01.09.2021, andaj edhe borxhi i debitorit ndaj kreditorit është përmbushur ne tërësi. Gjykata ne vendosjen e saj është bazuar ne nenin 71 par.1 nenpar.1.2 te LPP dhe ka vendosur si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës se Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata e shkallës se dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që edhe sipas vlerësimit të gjykatës ankimore aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe ligjor pasi përkitazi për rastin në fjalë, dispozita e nenit 66 par.4 parasheh që: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendim për përfundimin e procedurës përmbarimore”*.

Në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës së shkallës se dytë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur ka konsideruar si të përmbushur në tërësi detyrimin që rrjedh nga propozimi për përmbarim dhe kjo bazuar në parashtrësën e kreditorit të datës 14.09.2023 dorëzuar Gjykatës Komerciale–Dhomat e Shkallës e Parë përmes së cilit njofton gjykatën se: *“Tërhiqemi nga propozimi për përmbarim i dt. 01.09.2021 dhe urdhri për përmbarim P.nr. 508/21 dt.01.09.2021 për arsye se kreditori dhe debitori me datën 24.09.2022 kanë arritur marrëveshje dhe obligimi që debitori ka pasur ndaj kreditorit është përmbushur në tërësi. Andaj bazuar në ecurinë e shpjeguar më lartë, vlerën e kontestit prej 62,911.00 euro në e konsiderojmë si kontest të përfunduar në mes kreditorit Ex Project shpk dhe debitorit VB Invest shpk”*, nga rezulton se edhe përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë mbi përfundimin e procedurës përmbarimore në këtë çështje për përmbarim është i drejtë dhe i ligjshëm e të cilin qëndrim e përkrahë edhe gjykata ankimore.

Gjykata e shkallës se dytë analizoi edhe pretendimet ankimore të kreditorit por të njëjtat i vlerësoi si të pabazuara dhe jo relevante për një vendosje ndryshe në këtë procedurë, sepse i njëjti përmes parashtrësës së lartpërmendur ka ushtruar të drejtën e disponibël duke njoftuar se tërhiqet nga propozimi për përmbarim me konstatimin se detyrimi i debitorit ndaj kreditorit ka përfunduar ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës, kjo gjykatë vlerëson se vet kreditori në parashtrësën e ushtruar nuk e ka precizuar këtë kërkesë kur është tërhequr nga propozimi për përmbarim, andaj këto pretendime kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e shkallës se parë e vërtetoi.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë në Prishtinë për të vendosur në ana të gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS ,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1610/23, me datë 20.02.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi